VENDIM
Nr. 218, datë 7.4.2021

PËR RISHPËRNDARJE FONDESH NË BUXHETIN E VITIT 2021, MIRATUAR PËR MINISTRINË E FINANCAVE DHE EKONOMISË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 44, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të nenit 17, të ligjit nr. 137/2020, "Për buxhetin e vitit 2021", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në buxhetin e vitit 2021, miratuar për Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, të bëhet rishpërndarje e fondeve ndërmjet programeve buxhetore, si më poshtë vijon:

a) në programin buxhetor "Menaxhimi i të ardhurave tatimore" 01140 shtohet fondi prej 30 000 000 (tridhjetë milionë) lekësh në shpenzime kapitale për projektin "Përmirësimi i modulit të menaxhimit të kontrollit të faturimit";

b) në programin buxhetor "Arsimi i mesëm profesional" 09240 të pakësohet fondi prej 30 000 000 (tridhjetë milionë) lekësh, në shpenzime kapitale.

2. Ngarkohet Ministria e Financave dhe Ekonomisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe